



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizorit:

Agjencia për Rini dhe Sport

Lënda e revizionit:


Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2021 Llogaria e të ardhurave nga donacionet

Qëllimi i revizionit: Të fitohet bindje e arsyeshme për atë nëse raportet financiare të marrë si tërësi janë të lira nga paraqitjet e gabuara materialisht.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- Dobësitë dhe dispozita të pasakta në lidhje me angazhimin e personave për nevojat e projektit të Javës Evropiane të Sportit;
- mangësi në dokumentacionin për pagesën në lidhje me prokurimet e bëra me fondet e projektit.

Mendimi i dhënë *:



Është shprehur mendim pa rezervë për vërtetësinë dhe objektivitetin e elementeve nga raportet financiare Bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve dhe rezultatet e aktiviteteve financiare, ndërsa për pajtueshmërinë e aktiviteteve dhe transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante, udhëzimet dhe politikat e vendosura për vitin 2021 është shprehur mendim i pavolitshëm.

Rekomandimet kyçe:

- Ndryshimi i kontratave të cilat lidhen me personat e angazhuar në drejtim që do të sigurojë siguri në lidhje me vërtetësinë e pretendimeve për angazhimin e tyre dhe pagesat e bëra;
- Dokumentacioni adekuat i prokurimeve të bëra në drejtim të vërtetimit të vërtetësisë dhe objektivitetit të pagesave të kryera.

Dobësitë kyçe të sistemit:

/

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Janë marrë vërejtje për draft-raportin nga ana e drejtorit të Agjencisë për Rini dhe Sport.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

Vërejtja e marrë nuk është pranuar për shkak të mosdorëzimit të dëshmimeve me të cilat do ta ndryshonte gjendjen e konstatuar.

* pozitive me rezervë të pavolitshëm të përmbajtur